



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me pajisje për përgatitjen e ushqimit të koncentruar

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës të cilët posedojnë gjedhe, se mund të aplikojnë për furnizim me pajisje për përgatitjen (përzierjen) e ushqimit të koncentruar – Mikser 500 Kg/h .

Kriteret e përcaktuara :

- Të ketë 15 e më shumë krerë gjedhe;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuara;
- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve;
- Përparësi do të kenë fermerët të cilët nuk kanë përfituar në 3(tre) vitet e fundit pajisje për përgatitjen (përzierjen) e ushqimit të koncentruar - mikser nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Të jetë banor i komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) të ndodhet në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë.

Data e aplikimit nga : 22.07.2019 deri më 09.08.2019